




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës	
Kopje	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić,, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Qerkini, Ud. Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 08/05/2019 Nr. 020-253-5
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Podujevës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet baze dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01-060/01-0030178/19 që kompanisë private për distribuim dhe furnizim me energji elektrike „KEDS” i ndalohet vendosja e njehsorëve për matjen e energjisë elektrike në shtyllat e rrjetit elektrik dhe hapësirat publike në tërë territorin e komunës së Podujevës
I miratuar më datë më datë: 29.03.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08.04.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi 01-060/01-0030178/19 që kompanisë private për distribuim dhe furnizim me energji elektrike „KEDS” i ndalohet vendosja e njehsorëve për matjen e energjisë elektrike në shtyllat e rrjetit elektrik dhe hapësirat publike në tërë territorin e komunës së Podujevës	Vendimi i komunës nuk ka cekur bazën ligjore mbi të cilën mbështetet dhe arsyetohet Vendimi në fjalë. Neni 2 i Vendimit si arsyeje cekë “shkeljen e të drejtave elementare të njeriut që është siguria dhe transparenca në qasje të gjendjes së shpenzimeve elektrike në njësorët elektrik” por nuk përmbanë ndonjë dispozitë ligjore materiale me të cilën kjo e drejtë është e garantuar. Në këtë drejtim, MAPL konsideron se Vendimi në fjalë duhet të nxjerret në përputhje me Ligjin e aplikueshëm për Energjinë Elektrike i cili ndër tjera përcakton edhe të drejtat e konsumatorëve të energjisë elektrike.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Agim Velju, gradonačelnik Opštine Podujevo Fatmir Gashi, predsedavajući Skupštine opštine Podujevo	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini Pravno odeljenje i monitorisanje opština/ MALS	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MAPL-sa Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-u.	
Od:	Venera Çerkini v.d. Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Datum, 08.05.2019
Predmet:	Zahtev za reviziju akta Skupštine opštine Podujevo	Br. 020/253/5
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačleniče,
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 01-060/01-0030178/19 da privatnoj elektrodistribucijskoj kompaniji i snabdevanje sa električnom energijom „KEDS-u” zabranjuje postavljanje mereča za merenje električne energije na stubovima električne mreže i javnih prostora na celoj teritoriji opštine
Usvojena dana, 29.03.2019 godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 08.04.2019. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, procenjuje da je opštinski akt u suprotnosti **sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi.**

U nastavku možete pronaći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti

Br.	Formuliranje u opštinskom aktu	Zakonska odredba sa kojom je opštinski akt u suprotnosti.
1.	Odluka 01-060/01-0030178/19 da privatnoj elektrodistribucijskoj kompaniji i snabdevanje sa električnom energijom „KEDS-u“ zabranjuje postavljanje mereča za merenje električne energije na stubovima električne mreže i javnih prostora na celoj teritoriji opštine	Odluka opštine nije naznačila pravnu osnovu na kojoj se zasniva i opravdava navedena odluka. Član 2. odluke kao obrazloženje ističe“ kršenje elementarnih ljudskih prava kao što su bezbednost i transparentnost u pristup stanju potrošnje električne energije u električnim meračima“ ali ne sadrži nikakvu materijalnu zakonsku odredbu s kojom se ovo pravo garantuje. U tom smislu, MALS smatra da bi se dotična odluka trebala donositi u skladu sa važećim primenljivim Zakonom o električnoj energiji , koji između ostalog određuje prava potrošača električne energije.

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave, od Skupštine opštine i gradonačelnika Klokot, traži da preduzimaju konkretne mere kako bi akt opštine uskladili sa zakonskim odredbama na snazi, unutar predviđenog vremenskog roka od 30 dana od prijema zahteva za razmatranje akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za dalja objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komune e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Baruar në nenin 39 paragrafi 39.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03 L-040, nenit 65 paragrafi 65.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës si dhe nenin 33 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020-01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, sipas shkrësës së MAPI-së me nr prot.020-253/4 të datës 05.04.2019, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 04 mars 2019, ka miratuar:

VENDIMIN

QË KOMPANISË PRIVATE PËR DISTRIBUTIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE, "KEDS" I NDALOHET VENDOSJA E NJËSORËVE PËR MATJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NË SHTYLLAT E RRJETIT ELEKTRIK NË HAPËSIRAT PUBLIKE NË TËRË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Kuvendi i Komunës miraton vendimin që kompanisë private KEDS i ndalohet vendosja e njësorëve për matjen e energjisë elektrike në shpyllat e rrjetit elektrik në hapësirat publike në tërë territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 2

Arsyet e ndalimit të vendosjes së njësorëve për matjen e energjisë elektrike në hapësira publike bëhet për arsye të shkeljes së të drejtave elementare të njeriut që është siguria dhe transparencën në qasje të gjendjes së shpenzimeve elektrike në njësorët elektrik.

Neni 3

Kompania KEDS obligohet që t'i zhvendosë të gjithë njësorët elektrikë që i ka vendosur në majë të shpyllave elektrike në të gjithë territorin e Komunës së Podujevës që qytetarët të kenë qasje për ta parë gjendjet e shpenzimeve elektrike në një afat kohor prej 90 ditëve.

Neni 4

Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe shpërtimi administrativ nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrotjtjes së Mjedisit si dhe Drejtoria e Inspeksionit.

Nr. prot.01-060/01-0030178/19
Podujevë
08 prill 2019



Kryesuesi i Kuvendit
Enxhet Gashi

Ku vendim është protokolluar dhe nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit, në respektim të Shkrësës nr.020-253/4 të datë 05.04.2019 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.